



ХЕРА - Асоцијација за
здравствена едукација и
истражување

Франклин Рузвелт 51а/26,
1000 Скопје, Македонија

тел. +38923290395
факс. 02/ 2556002

Politika e privatësisë

1. Kontakt-të dhëna të kontrollorit të përmbledhjes së të dhënave personale

HERA – Asociacioni për edukim shëndetësor dhe hulumtim me seli në rr. “Franklin Ruzvelt” nr. 51a/26 Shkup, e-mail: hera@hera.org.mk

2. Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale

Zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale në HERA është personi Magdalena Arsovska.

Kontakt-informacione: magdalena.arsovska@hera.org.mk | (02) 3290 395

Për informacione shtesë dhe/ose realizimin e të drejtës Tuaj për mbrojtje të dhënave personale, mund ta kontaktoni Zyrtarin tonë për mbrojtje të dhënave personale.

3. Objektivat dhe baza juridike për përpunimin e të dhënave Tuaja personale

A) HERA, në kuadër të aktiviteteve të veta të projekteve, bën grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale, për çka paraqitet në rolin e Kontrollorit të dhënave personale.

Të dhënat personale që ne i përpunojmë për disa nga përdoruesit e shërbimeve janë: emri dhe mbiemri, vendbanimi, NVAQ dhe numri i letërnjoftimit (nëse e kanë), për të marrë shërbime të caktuara që i ofron organizata jonë. Për shembull, gjatë marrjes së rezultateve të PAP testit, gjatë përgatitjes së akteve/dokumenteve ligjore në emër të klientëve në të cilat duhet të futen të dhënat personale (ankesa, padi, deklarata, parashtresa etj.), si dhe në pjesën e ndihmës gjatë plotësimit të formularëve për realizimin e të drejtave në fushën e mbrojtjes sociale.

Klientët që nuk kanë nevojë për shërbimet e mësipërme dhe që përdorin shërbime të këshillimit ligjor, shërbime të tjera gjinekologjike, ekzaminime dermatovenerologjike, shërbime të tjera sociale, psikoterapi etj., regjistrohen me kode, ndërkohë që nuk ka mbledhje dhe përpunim të të dhënave personale të sipërpërmendura.



ХЕРА - Асоцијација за
здравствена едукација и
истражување

Франклин Рузвелт 51а/26,
1000 Скопје, Македонија

тел. +38923290395
факс 02/ 2556002

B) HERA kryen përpunimin e të dhënave personale nga ueb faqja në përputhje me bazat ligjore adekuate ([politika për kukis](#)), dhe atë me dhënien e pëlqimit nga ana Juaj për përdorimin e “kukis” në ueb-faqe.

C) Të dhënat të cilat subjektet i dërgojnë vullnetarisht përmes postës elektronike

Të dhënat personale që ne i mbledhim janë gjithashtu ato që Ju i dorëzoni vullnetarisht në rast të dërgimit të një mesazhi elektronik direkt në adresat tona të e-mail-it të lëna si kontakt në ueb faqe. Duke dërguar një mesazh të tillë elektronik në adresat tona elektronike, si të dhënë e marrim postën Tuaj elektronike, si dhe informacione të tjera që ju i keni ndarë vullnetarisht me ne si pjesë e mesazhit elektronik.

Ç) HERA bën përpunimin e të dhënave personale të punësuarve, vullnetarëve, aplikantëve për punë, bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe pjesëmarrësve në aktivitete në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dhënat personale mblihen, përpunohen dhe ruhen në përputhje me dispozitat e [Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve nënligjore](#). Të dhënat personale nuk përpunohen për ndonjë qëllim tjetër përveç qëllimit për të cilin janë mbledhur.

4. Në cilat afate i ruajmë të dhënat Tuaja personale?

Të dhënat të cilat i grumbullojmë ruhen në përputhje me ligjin dhe me aktet e brendshme të HERA-s.

5. Si i ruajmë dhe i mbrojmë të dhënat Tuaja personale?

HERA i përpunon të dhënat Tuaja personale në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale mbrohen nga aksesimi, zbulimi, përdorimi, ndryshimi ose shkatërrimi i paautorizuar. Të dhënat ruhen në ambientet tona të punës.

As HERA dhe as ofruesit e shërbimeve nuk do t'i përcjellin të dhënat Tuaja për përdorim tek palët e treta, përveç rastit kur ka pëlqim nga ana Juaj ose ka një detyrim ligjor.



**ХЕРА - Асоцијација за
здравствена едукација и
истражување**

Франклин Рузвелт 51а/26,
1000 Скопје, Македонија

тел. +38923290395
факс 02/ 2556002

Të punësuarit tanë janë të obliguar të punojnë në përputhje me aktet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të njëjtin obligim e kanë edhe ofruesit e shërbimeve.

6. Cilat janë të drejtat Tuaja?

Të drejtat Tuaja në raport me përpunimin e të dhënave personale janë:

- e drejta e informimit;
- e drejta e aksesit;
- e drejta e korrigjimit dhe fshirjes së të dhënave personale;
- e drejta e kufizimit të përpunimit të dhënave personale;
- e drejta e transferimit të dhënave;
- e drejta e ankesës për përpunim;
- e drejta e tërheqjes së pëlqimit;
- e drejta e parashtrimit të kërkesës te Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 97 nga Ligji për mbrojtje të dhënave personale.

Për informacione shtesë dhe/ose për realizimin e të drejtave Tuaja për mbrojtje të dhënave personale, mund ta kontaktoni Zyrtarin tonë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nëse besoni se mënyra në të cilën HERA i përpunon të dhënat Tuaja personale i shkel dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të na kontaktoni dhe t'i realizoni të drejtat tuaja ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Ndryshimi i politikës për privatësi

Ky Informacion mbi përpunimin e të dhënave personale mund të ndryshohet dhe plotësohet nga HERA, sipas nevojës ose kur ndryshojnë dispozitat ligjore. Versioni aktual i Informacionit mbi përpunimin e të dhënave personale do të publikohet gjithmonë dhe do të jetë i disponueshëm publikisht në ueb faqen e HERA-s.